



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



PROGRAMI I LËNDËS

GRAMATIKA DHE STRUKTURA E GJUHËS SË SHENJAVE DHE GJUHËS SË SHKRUAR 2

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminar

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti i tretë , semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Studenti thellon dhe zgjerohen aftësitë gjuhësore dhe në studime të fushës së gjuhës së shenjave, përdorimit të tyre në jetën e punës, vendosja e objektivave të qarta, të matshme dhe të arritshme për zbatimin e aftësive gjuhësore të shenjave, demonstroi se ka një fjalor të mjaftueshëm, të krijuar dhe produktiv, për t'u shprehur në disa rrethana për shumicën e temave që lidhen me jetën e tij të përditshme si: familja, hobet, interesat, puna, udhëtimet dhe ngjarjet aktuale, lidh një sërë elementesh të thjeshtë në një fjali/grupfjalish me anë të pikave kryesore të përmbajtjes së tyre, përdor një larmi rregullash gjuhësore për të përshkruar tema abstrakte ose kulturore si poezia me shenja ose filma, komunikoi me saktësi në bashkëbisedime duke demonstruar një kontroll të përdorimit të shenjave të gjuhës shqipe, paraqet me profesionalizëm dhe etikë se mund të bëhen gabime gjatë komunikimit me shenjat e gjuhës shqipe, por ato duhen eliminuar, përdor një larmi të gjerë funksionesh gjuhësore gjatë komunikimit me shenjat e gjuhës shqipe, dëshmon se ka kontroll të mirë gramatikor në strukturën e fjalisë, i korrigjon shpejt ato, përdor një shumëllojshmëri fjalësh lidhëse që janë të mjaftueshme për të shënuar qartë marrëdhënien ndërmjet ideve që transmeton me anë të shenjave.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Elementet gramatikor dhe struktura e gjuhës së shenjave dhe gjuhës së shkruar .
2. Përdorimi i elementeve gramatikore në përshkrimin e situatave vizuale (nga foto të ndryshme)
3. Të kuptuarit e informacionit nga gjuha e shenjave (mënyra e të shprehurit në rendin ndrushe të komunikimit)